

dialogu qeveridoronatorë

Buletin Informativ – Nëntor, Botimi nr. 54

Përpjekje e përbashkët e Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj dhe Sekretariatit Teknik të Donatorëve

www.dsdc.gov.al

www.aidharmonisation.org.al



■ Foto: Më datë 1 nëntor 2011, Qeveria shqiptare mbajti Tryezën e Rrumbullakët Qeveri-Donatorë, e bashkëkryesuar nga Ministri për Inovacionin dhe TIK-un, Genc Pollo dhe Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Alexander Arvizu, në cilësinë e kryetarit të radhës së Sekretariatit Teknik të Donatorëve.

Mbahet tryeza e rrumbullakët Qeveri - Donatorë

Më datë 1 nëntor 2011, Qeveria shqiptare mbajti Tryezën e Rrumbullakët Qeveri-Donatorë, e bashkëkryesuar nga Ministri për Inovacionin dhe TIK-un, Genc Pollo dhe Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Alexander Arvizu, në cilësinë e kryetarit të radhës së Sekretariatit Teknik të Donatorëve. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm zyrtarët më të lartë të Qeverisë dhe të komunitetit të donatorëve në Shqipëri. Ky forum i nivelit të lartë ishte një mundësi e shkëlqyer për Qeverinë dhe komunitetin e donatorëve për të diskutuar mbi progresin e arritur deri tani në lidhje me agjendën e reformave të Qeverisë, rritjen e bashkërendimit mes donatorëve dhe sfidat e radhës. Tryeza e Rrumbullakët Qeveri-Donatorë trajtoi çështje me rëndësi për Qeverinë dhe komunitetin e donatorëve. Ajo u fokusua në arritjen e reformave kyçe bazuar në agjendën qeveritare dhe progresin e arritur në zbatimin e SPI-së, si dhe kontributin e donatorëve në këtë drejtim. Ministri Pollo përmbledhi arritjet kryesore dhe reformat që Qeveria ka ndërmarë gjatë vitit të fundit

dhe impaktin e tyre në zhvillimin e vendit dhe në procesin e integritit evropian. Ai nënvizoi se është bërë progres i dukshëm, sidomos në zbatimin e Sistemit të Integruar të Planifikimit dhe ftoi donatorët të japin këndvështrimet e tyre për këtë sistem dhe çështje të tjera, gjatë sessionit të diskutimeve. Ambasadori Arvizu përgëzoi të gjithë donatorët për angazhimin e tyre dhe mbështetjen që i kanë dhënë integritit evropian dhe zhvillimit afatgjatë të Shqipërisë, duke theksuar se: “Ky është qëllimi dhe objektivi i përbashkët që ndikon në jetën dhe mundësitë e qytetarëve shqiptarë dhe ky forum është një mundësi e shkëlqyer për të parë dhe vlerësuar progresin e arritur dhe diskutuar mbi rrugën e ardhshme të vendit.”

Mbi tematikën e Integritit Evropian, tryeza u fokusua në progresin e arritur në plotësimin e rekomandimeve të Opinionit të KE-së të vitit 2010 të dhe hapat e ardhshëm në kontekstin e Raportit Analitik 2011 të tij. Në fund, Tryeza e Rrumbullakët u fokusua mbi qeverisjen e mirë dhe masat për zbutjen e efekteve të krizës ndërkombëtare financiare në rritjen eko-

nomike të Shqipërisë. Ky seksion përfshiu një prezantim të hollësishtëm të zbatimit të SPI-së dhe progresin e arritur në lidhjen e prioriteteve të Qeverisë me buxhetin e saj dhe me ndihmën e huaj. Tryeza nënvizoi progresin e SPI-së në lidhje me ngritjen e sistemit të monitorimit të SK-ZHI-së bazuar në rezultate, dhe theksoi se dhe u vu në dukje që fokusi duhet të zhvendoset drejt monitorimit tani që Shqipëria e ka përfunduar kuadrin strategjik. Në këtë aktivitet u theksua edhe nevoja për një fazë të dytë të SPI-së, për të forcuar konkurrueshmërinë ndërkombëtare të vendit dhe progresin në procesin e integritit evropian. Menaxhimi i shëndoshë makro-fiskal dhe kuadri solid i planifikimit dhe monitorimit të politikave, janë të domosdoshëm që Shqipëria të arrijë progres të qëndrueshëm drejt arritjes së objektivave strategjikë.

Takimi la gjurmë të thella në bashkërendimin mes donatorëve, duke shërbyer si një forum i përkryer për shkëmbimin e informacionit dhe dialogun konstruktiv për përmirësimin e efektivitetit të ndihmës së huaj në Shqipëri.

Në këtë numër

- Mbahet Tryeza e Rrumbullakët Qeveri-Donatorë
- Prezantim i Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë
- Konferenca Vjetore 2011 e Shoqatës së Ujësjellës-Kanalizimeve të Shqipërisë
- Enti Rregullator i Ujit miraton Metodologjinë për Vendosjen e Tarifave, e përgatitur me mbështetjen e GIZ-it
- Zvicra jep mbi 10 milion euro grant për Rehabilitimin e Sistemit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Lezhë dhe Shëngjin
- Programi i Energjisë i Kooperacionit Italian për Zhvillim: Ceremonia e përzemimit të nënstacionit Tirana
- Konferenca e 4-t e Nivelit të Lartë Delivering as One në Montevideo
- Sekretari Austriak i Shtetit dhe Përfaqësuesi i OKB-së diskutojnë për çështjet gjinore me komunitetet vendore në Kukës
- Konferenca "Analiza Gjinore e Programit të GIZ-it për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore dhe e Sektorit të Arsimit dhe Formimit Profesional në Shqipëri"
- Komiteti i Planifikimit Strategjik miraton paketën IPA 2012
- Zvicra mbështet Edukimin Shëndetësor në Vazhdim edhe me 1.5 milion euro
- Zbatim i përbashkët i Platformës së Edukimit dhe Ndërgjegjësimit për Drogat në shkollat fillore të Tiranës
- Trajnim i Njësive të Lëvizshme të Policisë Kufitare dhe Migracionit
- Eveniment në Shkollën e Magjistraturës për koordinimin e donatorëve
- Ngrihet Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në Tiranë
- Komunikimi për Ndryshimin e Sjelljes (COMBI) Kundër Dhunës në Shkollë
- Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike - Sfidë për Zhvillim
- Konferenca për Edukimin Mjedisor në Vlorë
- Koncerti ndëretnik ndez Teatrin e Metropolit
- Raporti Periodik Ekonomik për Evropën Juglindore

Prezantim i Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë

Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë u hap në mars 2011, pas nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet autoriteteve shqiptare dhe Këshillit të Evropës. Marco Leidekker e mori emërimin si Shefi i Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë më 1 mars 2011.



■ Foto: Shefi i Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, Marco Leidekker

Marco Leidekker (Holandë, 1968) është diplomuar për juridik në Universitetin e Lejdenit. Pasi kreu shërbimin ushtarak dhe punoi si ndihmës infermier psikiatrik dhe kërkues shkencor, iu bashkua Ministrisë së Drejtësisë ku mbulonte çështjet e migrimit, burgjeve, reformës në polici dhe krimit të organizuar. Në periudhën 2001-2005, Marco Leidekker u vendos në Bruksel ku ndihmoi Komisionin Evropian që të krijonte qasjen e Bashkimit Evropian kundrejt drogave sintetike dhe në vitin 2004 u atashua pranë Përfaqësuesit të Përhershme Holandeze në BE, gjatë periudhës kur Holanda mbante presidentin e BE-së. Në vitet 2005-2011, punoi për Komitetin Evropian të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Ndëshkimin Çnjerëzor dhe Poshtëruar (CPT).

Detyrat kryesore të kësaj Zyre janë: përfaqësimi i Sekretarit të Përgjithshëm të KiE-së në marrëdhëniet me autoritetet shqiptare; promovimi dhe mbështetja e politikave dhe aktiviteteve të autoriteteve shqiptare, si edhe i të organeve të Këshillit të Evropës, në lidhje me anëtarësimin në KiE; këshillimi, mbështetja dhe koordinimi i përgjithshëm me autoritetet shqiptare në lidhje me planifikimin, negocimin dhe zbatimin në kohë të aktiviteteve bashkëpunuese të përcaktuara nga Këshilli i Evropës, përfshi Programet e Përbashkëta me Bashkimin Evropian dhe donatorë të tjerë; dhe lehtësimi i identifikimit të nevojave për forcim kapacitetesh, në bashkëpunim me autoritetet shqiptare.

Aktivitetet e Këshillit të Evropës gjatë nëntorit 2011

Më 15-16 nëntor 2011, u organizua trajnimi i përbashkët për 'Hartimin e Legjislacionit dhe Indikatorët e Efektivitetit', (në kuadrin e KiE/DG 1/Departamenti i Aksionit kundër Krimit/Projekti i BE-së kundër Korrupsionit në Shqipëri - PACA) nga PACA dhe Projekti 'Konsolidimi i Sistemit Shqiptar të Drejtësisë' (EURALIUS III). Në trajnim morën pjesë 24 përfaqësues të departamenteve të hartimit të legjislacionit nga ministritë e Drejtësisë; Punëve Publike dhe Transportit; Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta; Turizmit dhe Kulturës; Mbrojtjes; Arsimit dhe



■ Foto: Trajnim për bashkëpunimin ndërmjet bashkive, organizuar në Shkodër nga Këshilli i Evropës me mbështetjen e Zyrës Zvicereane për Bashkëpunim.

Shkencës.

Më 15-18 dhe 23-25 nëntor 2011, pas një cikli prej tre trajnimesh nga ekspertë ndërkombëtarë (të angazhuar nga Instituti i Bazelit për Qeverisje) për trajnuesit e policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit, u organizuan edhe dy trajnime të tjera për trajnuesit në Vlorë. Në këtë aktivitet morën pjesë 34 oficerë policie, prokurorë dhe gjyqtarë nga Vlora, Berati, Fieri, Lushnja, Gjirokastra, Durrësi, Elbasani, Korça, Lezha, Shkodra, Kukësi, Dibra dhe Tirana. Trajnuesit e trajnuar nga PACA zotëruan mirë metodologjinë dhe materialet trajnuese të PACA-s, të cilat ishin ndërvepruese, të ndërtuara rreth një çështjeje të simuluar dhe të bazuar në përdorimin e mjeteve të automatizuara për kryerjen e analizës financiare të korrupsionit dhe pastrimit të parasë.

Më 22-25 nëntor 2011, Këshilli i Evropës në kuadrin e projektit “Forcimi i Strukturave të Qeverisjes Vendore dhe Rajonale” të financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Shqipëri (SCO-A), organizoi tre trajnime në nivel qarku në Shkodër, Durrës dhe Vlorë. Trajnimi synonte të rriste njohuritë dhe botëkuptimin për përfitimet, pengesat, risqet dhe teknikat e bashkëpunimit ndërmjet bashkive, qartësimin e kuadrin ligjor shqiptar, inkurajimin e formimit të partneriteteve dhe evidentimin e fushave potenciale për bashkëpunim.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm 67 pjesëmarrës, 55 nga të cilët ishin përfaqësues të Njësive të Qeverisjes Vendore, 4 nga Ministria e Brendshme dhe 8 nga SCO-A, Programi për Decentralizimin dhe Zhvillimin Vendor dhe KiE. Në trajnim morën pjesë edhe Zëvendësministri i Brendshëm, Ferdinand Poni, Shefi i Zyrës së KiE-s në Tiranë, Marco Leidekker dhe Zyrtarja e Programit Kombëtar në SCO-A, Elda Bagaviki.

Më 22 nëntor 2011, Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike e cila përfiton edhe nga mbështetja që jep SCO-A, shpalli programin 2011-2012 për pjesëmarrësit e rinj. Pjesa e parë e programit konsiston nga një bllok prej 3 seminaresh që fokusohen në partitë politike, zgjedhjet dhe ideologjitë. Për të marrë pjesë në programin 2011-2012 janë zgjedhur 33 profesionistë të rinj nga partitë politike, administrata publike, media, pushteti vendor, shoqëria civile, gjyqësor, organizatat ndërkombëtare dhe qarqet akademike.



■ Foto: Kryeministri Sali Berisha, Ambasadorja Gjermane, Carola Müller-Holtkemper, Ministri i Mjedisit, Fatmir Mediu dhe Këshilltarja e Kryeministrit për Çështjet e Ujit, Enkelejda Gjinali, gjatë ceremonisë gala që hapi konferencën vjetore për vitin 2011



■ Foto: Konferenca Vjetore 2011 e Shoqatës së Ujësjellës-Kanalizimeve të Shqipërisë “Ujë dhe Kanalizime për Qytetarët: Përgjigje ndaj Zhvillimit Urban”

Konferenca Vjetore 2011 e Shoqatës së Ujësjellës-Kanalizimeve të Shqipërisë

Konferenca Vjetore 2011 e Shoqatës së Ujësjellës-Kanalizimeve të Shqipërisë “Ujë dhe Kanalizime për Qytetarët: Përgjigje ndaj Zhvillimit Urban” u mbajt në Tiranë, më 1-3 nëntor 2011. Konferenca kishte 78 folës dhe moderatorë, përveç mbi 500 pjesëmarrës vendas dhe të huaj nga rajoni, BE-ja dhe Afrika. Kryeministri Sali Berisha dhe Ambasadorja Carola Müller-Holtkemper mbajtën fjalën gjatë pritjes gala që hapi Konferencën dhe Ekspozitën. Kryemi-

nistri Berisha theksoi në fjalën e tij se shoqëria shqiptare duhet të ndryshojë në mënyrë radikale qëndrimin ndaj problemit të ujit. Ai shprehu angazhimin e qeverisë për të punuar me vendosmëri që të menaxhohet më mirë potenciali i madh ujqor i Shqipërisë. Në këtë ceremoni folën edhe zyrtarë të tjerë të lartë si Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Fatmir Mediu dhe Kryetari i Shoqatës së Ujësjellës-Kanalizimeve të Shqipërisë, Sahit Dollapi. Në ceremoni morën pjesë përfaqësues të komunitetit të donatorëve dhe të institucioneve ndërkombëtare që mbështesin sektorin e ujit në Shqipëri. Më pas, u ndanë çmime për personat dhe institu-

cionet që kanë dhënë kontribut të çmuar për rritjen dhe objektivat e Shoqatës. Agjencia Austriake për Zhvillim mori Çmimin e Mbështetjes për mbështetjen bujare që i ka dhënë Grupit të Profesionistëve të Rinj të Ujit të Shqipërisë gjatë vitit të parë të krijimit. Po ashtu, çmimi vjetor i Bordit Drejtues shkoi për inxhinierin Engjëll Gjondrekaj, për pasionin dhe përkushtimin e tij për ngritjen e një organizate që synon nivelet më të larta të profesionalizmit në ofrimin e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve për shqiptarët. Kryeministri Sali Berisha u dorëzoi certifikatat 12 fëmijëve fituesve të programit “Miq të Ujit”, të cilët kishin shprehur artistikisht ndjenjat e tyre për rëndësinë e ujit dhe mjedisit. Në Ekspozitën Vjetore të organizuar bashkë me Konferencën e 11-të Vjetore, morën pjesë 27 shoqëri shqiptare dhe të huaja, të cilat njohën profesionistët e ujësjellës-kanalizimeve me teknologji të reja dhe ekspertizën që i shërben këtij sektori.

Edicioni i 11-të i Konferencës Vjetore ishte e ndarë në sesione, ku temat kryesore ishin: rajonalizimi i ndërmarrjeve të ujësjellësit; anketat e sektorit të ujit; media; shërbimi ndaj klientit – komunikimi dhe ndërprerja e shërbimit; kontrolli i humbjeve të ujit; grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të përdorur dhe i mbetjeve; autoriteti rregullator i ujit - sfidat e ardhshme; menaxhimi i burimeve të ujit; cilësia e ujit; sesionet e Profesionistëve të Rinj të Ujit për zhvillimet teknike, zhvillimin profesional dhe përgjegjësinë sociale.

Komentet e dhëna nga pjesëmarrësit në Konferencë e bindën Personelin dhe Bordin Drejtues të Shoqatës se u trajtuan sesione me cilësi të lartë që kanë impakt në problematikën aktuale të sektorit të ujit në Shqipëri. Një sesion i veçantë i Konferencës iu kushtua ceremonisë së dorëzimit të certifikatave për rreth 40 studentë të Departamenteve të Mjedisit Mjedisore dhe të Inxhinierisë Hidroteknike në Fakultetin e Inxhinierisë në Tiranë, të cilët morën pjesë në Programin e Stazhit Veror të Shoqatës për vitin 2011.

Konferenca u organizua në bashkëpunim të ngushtë teknik me Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, me Ministrinë e Mjedisit dhe me mbështetjen financiare të GIZ-it përmes Programit ‘Reforma e Sektorit të Ujit në Shqipëri’.



■ Foto nga seminari i GIZ në Kukës për zbatimin e Metodologjisë për Vendosjen e Tarifave

Enti Rregullator i Ujit miraton Metodologjinë për Vendosjen e Tarifave, e përgatitur me mbështetjen e GIZ

Krijimi i instrumenteve rregullatore që mbështetin ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri që të ofrojnë shërbime të cilësisë së lartë, efçente dhe të përballeshme ndërkohë që e orientojnë sektorin drejt vetëqëndrueshmërisë financiare, përbën thelbin e bashkëpunimit ndërmjet Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë (ERRU) dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ).

Më 28 shtator 2011, Komisioni Rregullator Kombëtar i ERRU-s miratoi Metodologjinë e re për Vendosjen e Tarifave të përgatitur me mbështetjen e GIZ-it përmes Programit ‘Reforma në

Sektorin e Ujit’, që i vuri në dispozicion entit rregullator përvojën dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Në kontekstin e ndryshime gjithëpërfshirëse që po ndërmerren në kuadrin e qasjes së re të vendosjes së çmimeve dhe tarifave, partnerët kanë realizuar konsultime të plota me ofruesit e shërbimeve dhe grupet e tjera të interesit në këtë sektor. Metodologjia përcakton objektiva të qartë për rikuperimin e kostos, efçencën, aftësinë paguese dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Për herë të parë do të ekzistojë një lidhje e drejtpërdrejtë mes performancës së ndërmarrjes dhe tarifave të rregulluara, për të inkurajuar rritjen e efçencës nga ana e ofruesve të shërbimeve. Operatorëve u kërkohet të justifikojnë të gjitha kostot e tyre dhe të demonstrojnë se këto janë ‘të nevojshme dhe të arsyeshme’ për të përmirësuar shërbimet përpara se të rriten tarifat. Një risi e metodologjisë janë



■ Foto: Z. Dervishi prezanton në konferencë metodën e re për vendosjen e tarifave



■ Foto e ballinës së Metodologjisë

Dëgjuesat e detyrueshme Publike, me qëllim që të dëgjohen pikëpamjet dhe shqetësimet e konsumatorëve shqiptarë; gjithashtu, ofruesi i shërbimeve duhet të paraqesë një platformë për informimin e konsumatorëve në lidhje me performancën e saj dhe objektivat për të ardhmen.

Më 24-28 tetor 2011, një seri trajnimesh u organizuan në Kukës, Tiranë dhe Fier për sa i përket zbatimit të Metodologjisë për Vendosjen e Tarifave. Ofruesit e shërbimeve pjesëmarrës në këto aktivitete u treguan mjaft aktive dhe prej tyre u mor *feedback* shumë pozitiv. Metodologjia e re e vendosjes së tarifave përfaqëson një hap përcaktues për të përmbushur mandatin e ERRU-s, si edhe për të realizuar objektivat e reformës të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017, e cila synon të garantojë ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime për të gjitha shqiptarët.

Zvicra jep mbi 10 milion euro grant për Rehabilitimin e Sistemit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Lezhë dhe Shëngjin

Marrëveshja e re ndërmjet Zvicrës dhe Shqipërisë mundëson rehabilitimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve në Lezhë dhe Shëngjin dhe forcon kapacitetet institucionale të ndërmarrjes së ujësjellësit. Nga ky projekt do të përfitojnë rreth 45 000 banorë të Lezhës, Shëngjinit dhe Balldrenit.

Më 17 nëntor 2011, Qeveria shqiptare dhe Zvicra nënshkruan marrëveshjen që mundëson rehabilitim të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve në Lezhë dhe Shëngjin. Ambasadorja zvicerane Yvana Enzler, Ministri i Financave, Ridvan Bode dhe Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Sokol Olldashi, nënshkruan marrëveshjen e cila i hap rrugë grantit



■ Foto: Nënstacioni Tirana 2 në Kashar

prej 10,53 milion eurosh. “ky është një hap më tepër për të garantuar sistemeve funksionale të furnizimit me ujë për qytetarët shqiptarë”, tha Ambasadorja zvicerane, Yvana Enzler gjatë fjalimit të saj. Në fjalimin e tij, Ministri i Financave, Ridvan Bode lavdëroi bashkëpunimin me Zvicrën dhe përmendi përparimin e bërë në sektorin e ujit përmes ndërhyrjeve ku Sekretariati Zviceran Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), KfW, ministritë e linjës, bashkitë dhe ndërmarrjet e ujit kanë punuar së bashku për të siguruar furnizim të vazhdueshëm me ujë.

Pritet që 45 000 banorë të Lezhës dhe Shëngjinit të gëzojnë ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje në shtëpitë e tyre, si edhe një sistem më të sigurt dhe funksional për ujërat e zeza. Kjo do të ketë një efekt në ekonominë vendore, mbrojtjen e mjedisit dhe në potencialin turistik të Shëngjinit. Pas Pogradecit dhe Shkodrës, ky është projekti i tretë i financuar nga Zvicra, duke çuar numrin e përfituesve në 220 000 qytetarë të cilët gëzojnë furnizim të vazhdueshëm me ujë, sisteme të pastra dhe të sigurta të ujërave të zeza, dhe ndërmarrje të ujësjellësit me kapacitete më të mira në menaxhuese. Sistemet e furnizimit me ujë nëpër Shqipëri kanë nevojë për rinovim dhe rehabilitim; kjo kërkon investime në infrastrukturë dhe forcim kapacitetesh për ndërmarrjet e ujësjellësit.

Zyra Zvicerane për Bashkëpunim e ndjek me interes të veçantë sektorin e ujit në Shqipëri. Rehabilitimet e suksesshme të mundësuar nga SECO u përmendën edhe në konferencën e zhvilluar në Nojshatell të Zvicrës, më 25 nëntor 2011.

Programi i Energjisë i Kooperacionit Italian për Zhvillim: Ceremonia e përirimit të nënstacionit Tirana 2

Më 18 nëntor 2011, u zhvillua në Kashar (Tiranë) ceremonia e përirimit të nënstacionit Tirana 2, në prani të kryeministrit Sali Berisha, ish-Ambasadorit italian, Saba D’Elia dhe Drejtorit të Kooperacionit Italian për Zhvillim, Aldo Sicignano, si edhe të drejtuesve të lartë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) në Shqipëri. Në kuadrin e Programit për forcimin e sistemit elek-



■ Foto: Kryeministri Sali Berisha, ish-Ambasadori Italian në Tiranë, Saba D’Elia dhe Drejtori i Kooperacionit Italian për Zhvillim, Aldo Sicignano

trik shqiptar, Kooperacioni Italian ka akorduar 90 milion euro për ta përshtatur sistemin me standardet evropiane dhe për ta integruar me rrjetin elektrik të Ballkanit.

Gjatë ceremonisë, Kryeministri Sali Berisha theksoi rëndësinë strategjike të infrastrukturës së re, e cila lidh rrjetin kombëtar me linjat rajonale, përfshi Kosovën, duke i mundësuar kështu Shqipërisë importimin dhe eksportimin e energjisë.

Kryeministri vuri në dukje edhe angazhimin e fortë financiar të Kooperacionit Italian në sektorë jetikë të ekonomisë shqiptare, si në Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme dhe energjia. Në këtë kontekst, iu referua Programit italo-shqiptar për zhvillimin e NVM-ve dhe dy objektet e tjera infrastrukturore të parashikuara në kuadrin e Programit të Energjisë, konkretisht: ndërtimi i linjës elektrike të tensionit të lartë Elbasan-Tiranë (e përfunduar) dhe ngritja e një qendre dispeçere dhe telekontrollin e rrjetit elektrik (projekt në fazë realizimi). Ish-Ambasadori italian, Saba D'Elia, shpjegoi se transmetimi dhe shpërndarja e duhur e energjisë elektrike ka impakt të konsiderueshëm në nivel makroekonomik, pasi tërheq investime të huaja direkte shtesë në Shqipëri. Ai shprehu mirënjohjen për [Ansaldo T&D JSC](#) dhe [Carlo Gavazzi Impianti Ltd](#) për punën e shkëlqyer të bërë me nënstacionin Tirana 2, si dhe përmendi shoqëritë e tjera italiane të angazhuara në zbatimin e Programit të Energjisë, konkretisht Terna për linjën e tensionit të lartë Elbasan-Tiranë dhe ABB Italy për qendrën dispeçere dhe telekontrollit.

Nënstacioni Tirana 2 është realizuar me teknologji moderne që kryen funksionin e uljes/ngritjes së tensionit elektrik, në mënyrë që energjia elektrike të shpërndahet në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase, e gjitha në përfitim të shoqërive dhe të qytetarëve. Nisma është ideuar dhe zbatuar në bashkëpunim me palën shqiptare: me OST-në dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE).

Punimet për ndërtimin e nënstacionit me shumë mbi 20 milion eurosh u kryen nga firma Ansaldo T&D dhe nga Impianti Carlo Gavazzi, dy shoqëri italiane lider në fushën e transmetimit të energjisë.



■ Foto: Autoritetet ndërkombëtare shkëmbejnë përvojat dhe rezultatet e procesit të reformave të OKB-së, me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit për zhvillim

Konferenca e 4-t e Nivelit të Lartë Delivering as One në Montevideo

Më 8-10 nëntor 2011, përfaqësues të 30 qeverive, ekspertë dhe autoritetet bashkëpunimi shumëpalësh, u mbledhën në Montevideo të Uruguajt, në edicionin e 4-t të Konferencës së Lartë Ndërqeveritare për *Delivering as One*. Qëllimi i Konferencës ishte shkëmbimi i përvojës dhe vlerësimi i rezultateve të procesit të reformave të OKB-së, *Delivering as One*. Që në vitin 2007, tetë shtete pilot (Shqipëria, Kepi Jeshil, Mozambiku, Pakistani, Ruanda, Tanzania, Uruguai dhe Vietnam) janë pjesë e nismës *Delivering as One*, objektivi i të cilës është përmirësimi i koordinimit mes agjencive, fondeve, programeve dhe komisioneve të ndryshme të OKB-së. Gjatë viteve të fundit, mbi 20 vende kanë filluar një punë të tillë, bazuar në nismën *Delivering as One*.

Konferenca e Montevideos për *Delivering as One* konfirmoi rëndësinë e (a) zotërimit kombëtar dhe lidhshimit qeveritar; (b) shkëmbimit të gjerë të mësimave të nxjerra; (c) financimit të përbashkët, të parashikueshëm dhe shumëvjeçar, por jo i detyrueshëm për një operacion të caktuar; (d) njohjes së kontekstit të zhvillimit që ka secili vend; dhe (e) forcimit të mëtejshëm të rolit të Koordinatorit të Përhershëm. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e vlerësimit të pavarur, si një input për QCPR (shqyrtimin tërësor 4-vjeçar të politikave). Konferenca u

karakterizua nga mirëkuptimi i përgjithshëm se duhen aplikuar qasje që mundësojnë programim të lehtë dhe fleksibël, i përshtatur sipas situatës specifike të secilit vend, si edhe duhen përdorur avantazhet krahasuese të agjencive të OKB-së për të mbështetur zotërimin dhe prioritetet kombëtare. Pjesëmarrësit shprehën vullnetin që të forcohet multilaterizmi dhe të konfirmohet sistemi i OKB-së si një forum i rëndësishëm për adresimin e agjendës së zhvillimit. Konferenca ra dakord që, bazuar në përvojën, arritjet dhe mësimet e nxjerra, është koha që nisma *Delivering as One* ta tejkalojë fazën pilot.

Edicioni i radhës i Konferencës së Nivelit të Lartë *Delivering as One* do të mbahet në Tiranë në vitin 2012.

Sekretari Austriak i Shtetit dhe Përfaqësuesi i OKB-së diskutojnë për çështjet gjinore me komunitetet vendore në Kukës

Më 10 nëntor 2011, Sekretari Austriak i Shtetit, Wolfgang Waldner bëri një vizitë në Shqipëri, gjatë të cilës u takua me përfaqësues të qeverisë shqiptare dhe zyrtarë të tjerë. Ai vizitoi edhe qytetin verior të Kukësit, ku u takua me përfaqësuesit e Bashkisë dhe të shoqërisë civile. Sekretari i Shtetit shoqërohej nga Ambasadori Austriak, Florian Rauning, Shefja e Zyrës Austriake për Zhvillim, Astrid Wein dhe nga zyrtarë të OKB-së në Shqipëri. Sekretari i Shtetit

u njoh me progresin e bërë për barazinë gjinore në Shqipëri nëpërmjet Programit të Përbashkët të OKB-së për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje. Në këtë kontekst, Sekretari i Shtetit dëgjoi me kënaqësi për progresin në lidhje me buxhetimin gjinor në bashkinë e Kukësit dhe me përpjekjet për të përmirësuar mbrojtjen sociale për gratë, e kurorëzuar me miratimin e ndryshimeve me aspekt gjinor në Ligjin për Ndhimën Ekonomike para disa muajsh. Përfaqësuesit e Policisë së Shtetit e vunë në dijeni për përmirësimet e bëra në përballimin e çështjeve të dhunës në familje, si edhe nënvizuan rritjen e dukshme të besimit të publikut te autoritetet publike, çka pasqyrohet nga rritja e numrit të femrave të abuzuara që denoncojnë dhunën. Anëtarët e shoqërisë civile informuan Sekretarin e Shtetit për pjesëmarrjen në vendimmarrje, një sfidë kjo për femrat në Kukës. Ata thanë se fenomeni i votimit familjar është ulur ndjeshëm gjatë zgjedhjeve vendore të majit dhe se është rritur pjesëmarrja e grave në procesin e votimit. Aktivistët e shoqërisë civile raportuan edhe për procesin novator të *scorecards* së qytetarëve, të përdorura gjatë fushatës për zgjedhore vendore 2011. Me procesin e *scorecard-ave*, gratë e komuniteteve vendore evidentuan shqetësimet e tyre dhe vlerësuan me notë bashkitë në lidhje me reagimin e tyre ndaj nevojave të grave. Sekretari i Shtetit vlerësoi përpjekjet e pjesëtarëve të komunitetit të Kukësit për ngritjen e sistemit të referimit për dhunën në familje. Në këtë takim, Drejtori i Zyrës së UNDP-së për Shqipërinë,



■ Foto: Kryebashkiaku i Kukësit, Hasan Halili dhe zv. Kryebashkiakja Alketa Cenaj përshëndetin Sekretarin Austriak të Shtetit, Waldner dhe Ambasadorin Austriak, Rauning

Norimasa Shimomura nënvizoi arritjet kryesore të Shqipërisë me mbështetjen e Programit të Përbashkët të OKB-së për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje, përmirësimet në legjislacionin dhe kuadrin politik, rritjen e kapaciteteve të nëpunësve publikë për të kuptuar sfidat gjinore dhe për të zbatuar legjislacionin gjinor, përmirësimet e dukshme të shërbimeve për të mbijetuar e dhunës në familje, krijimin e një baze solide për statistikat gjinore, si edhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje. Programi i Përbashkët zbatohet që nga viti 2008 prej katër agjencish të OKB-së UN Women, UNFPA, UNICEF dhe UNDP. Austria është një ndër kontribuuesit e Fondit të Koherencës së OKB-së, që mundësoi zbatimin e këtij Programi të

Përbashkët.

Sekretari i Shtetit siguroi pjesëmarrësit se Austria do të vazhdojë të mbështetë Kombet e Bashkuara, kauzën e barazisë gjinore dhe popullin shqiptar.

Konferenca "Analiza Gjinore e Programit të GIZ-it për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore dhe e Sektorit të Arsimit dhe Formimit Profesional në Shqipëri"

Më 3 nëntor 2011, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, bashkë me Programin e GIZ për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore/Arsimit dhe Formimit Profesional, organizoi konferencën për të paraqitur konstatimet dhe rekomandimet kryesore të analizës gjinore të përgatitur në kuadrin e programit të GIZ. Të pranishëm në takim ishin rreth 45 përfaqësues nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, AKAFP, SHKP, Bashkia Tiranë, Universiteti i Tiranës/Fakulteti i Shkencave Sociale, organizatat ndërkombëtare, OJF vendore dhe media lokale.

Studimi ofron një panoramë të plotë të situatës aktuale dhe thekson se në dy vitet e fundit, qeveria shqiptare ka forcuar angazhimin për barazinë gjinore dhe fuqizimin ekonomik të grave. Ky angazhim është mishëruar në një sërë strategjish kombëtare, sektoriale dhe ndërsektoriale që kulmojnë me Strategjinë Kombëtare



■ Foto: Takimi në bashkinë Kukës, (nga e majta: Ambasadori austriak, Rauning, Sekretari i Shtetit, Waldner, Kryebashkiaku Halili, Drejtori i Zyrës së UNDP-së për Shqipërinë, Shimomura dhe Shefja e Zyrës Austriake për Zhvillim, Wein)

për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje 2011-2015. Por me gjithë këto përpjekje, vazhdon të ketë pabarazi mes grave dhe meshkujve për sa i takon Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP), punësimit, mundësive për karrierë. Politikave AFP u mungon analiza gjinore si rezultat i mungesës si treguesve cilësorë gjinorë dhe përdorimit të paketë të statistikave gjinore.

Në këtë drejtim, studimi jep disa rekomandime praktike për strukturat shtetërore dhe për donatorët aktivë në këtë fushë, me qëllim që të mbushin më mirë boshllëqet gjinore në sistemin AFP, duke u fokusuar në tre nivele: harmonizimi dhe rishikimi i politikave, reforma strukturore dhe koordinimi, trajnimi dhe metodologjia.



■ Foto: Konferenca për Analizën Gjinore të Programit të GIZ-it për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore dhe të Sektorit të Arsimit dhe Formimit Profesional në Shqipëri, organizuar në kuadrin e programit të GIZ-it

Komiteti i Planifikimit Strategjik miraton paketën IPA 2012

Më 18 nëntor 2011, Komiteti i Planifikimit Strategjik u mblodh për të diskutuar dhe për të miratuar paketën e asistencës prej 84,3 milion euro që Komisioni Evropian ka akorduar në kuadrin e programit IPA 2012. Kjo asistencë do të financojë disa projekte që synojnë vazhdimin e reformave të qeverisë, zhvillimin e infrastrukturës, si edhe zhvillimin dhe konsolidimin e institucioneve shqiptare në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë.

Takimi u kryesua nga kryeministri Sali Berisha. Ai tha se policia dhe drejtësia janë fusha prioritare që do të mbështeten nga ky program. Programi parashikon edhe investime të rëndësishme, si ndërtime

mi i Pallatit të Drejtësisë. Investime do të bëhen edhe për sistemin e ujërave të përdorur të Vlorës dhe bypass-in e Vlorës. Mbështetje është parashikuar edhe për shoqërinë civile.

Zvicra mbështet Edukimin Shëndetësor në Vazhdim edhe me 1.5 milion euro

Zvicra ka dhënë një fond shtesë prej mbi 1,5 milion euro për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetit. Ky projekt është një nismë novatore që inkurajon të gjithë profesionistët e shëndetësisë të rrisin aftësitë e tyre vazhdimisht, duke garantuar kështu një person të motivuar dhe cilësi më të mirë të shërbimeve shëndetësore.

Më 18 nëntor 2011, qeveritë e Zvi-

crës dhe Shqipërisë nënshkruan për mbështetjen e reformës së sistemit shëndetësor nëpërmjet një projekti që synon ngritjen e sistemit të edukimit shëndetësor në vazhdim. Sipas marrëveshjes së re, Zvicra akordon mbi 1,5 milion euro për të konsoliduar këtë sistem edukimi në vazhdim, me qëllim që të garantohet funksionimi i qëndrueshëm afatgjatë i tij. Impakti i pritsëm është përmirësimi i cilësisë së kujdesit të ofruar nga institucionet dhe shërbimet shëndetësore, ashtu si edhe gatishmëria reaguese e tërë sistemit shëndetësor.

Marrëveshja u firmos nga Ambasadorja zvicerane, Yvana Enzler dhe Ministri i Shëndetësisë, Petrit Vasili, në Ministrinë e Shëndetësisë. “Sot ne ripërtërijmë angazhimin tonë për të mbështetur profesionalizmin e punonjësve të kujdesit shëndetësor”, tha Ambasadorja Yvana Enzler. “Ne besojmë se nëpërmjet projektit të Sistemit për Zhvillimin Profesional ne do të inkurajojmë profesionistët e shëndetësisë për të përmirësuar njohuritë, aftësitë, dhe informacionin për të shërbyer më mirë nevojave të popullsisë”, vazhdoi Ambasadorja Enzler.

Kjo është faza e dytë e projektit të Sistemit për Zhvillimin Profesional të nisur në vitin 2007 dhe i cili ndihmoi në krijimin e Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim dhe mundësoi themelimin e sistemit të akreditimit dhe të ri-certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë. Qëllimi i kësaj faze të dytë, e zbatuar dhe e mbështetur nga asistencat teknike e Qendrës Spitalore të Universitetit të Montrealit, është forcimi i



■ Foto: Mbledhja e Komitetit të Planifikimit Strategjik më 18 nëntor 2011

kapaciteteve të Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim dhe të aktorëve të tjerë, si edhe rritja në shkallë kombëtare e aksesit në edukimin në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë të të gjitha kategorive.

Në fund të kësaj faze, do të ngrihet një sistem kombëtar për akreditimin e programeve të edukimit mjekësor në vazhdim mjekësor për të gjitha kategoritë e profesionistëve shëndetësorë, si edhe për ri-certifikimin e mjekëve, farmacistëve dhe dentistëve.

Zbatim i përbashkët i Platformës së Edukimit dhe Ndërgjegjësimit për Drogat në shkollat fillore të Tiranës

Më 22 nëntor 2011, tre efektive të Policisë së Shtetit u nderuan me Certifikatën e Mirënjohjes nga Ambasadori amerikan, Alexander Arvizu, gjatë ceremonisë së mbajtur për zbatimin e përbashkët të Platformës së Edukimit dhe Ndërgjegjësimit për Drogat në shkollat fillore të Tiranës. Drejtori i Policisë së Qarkut Tiranë, Saimir Muçaj, Shefi i Seksionit të Patrullës së Përgjithshme, Bedri Hasanaj dhe Shefi i Sektorit, Arben Nasufi, u vlerësuan për kontributin e tyre në këtë projekt. Me të njëjtën certifikatë u vlerësua edhe Drejtorja e Drejtorisë Arsimore të Tiranës, Arjana Bekteshi.

Ky projekt po zbatohet në shkollat e Tiranës me mbështetjen e programit IC-



■ Foto: Nënshkrimi i marrëveshjes mes Ambasadores zvicerane, Yvana Enzler dhe Ministrit të Shëndetësisë, Petrit Vasili, në Ministrinë e Shëndetësisë më 18 nëntor 2011.

ITAP, Zyra e Bashkëpunimit për Mbrojtjen, Ambasada Amerikane dhe Garda Kombëtare e Nju Xhersit. Ambasadori Arvizu vlerësoi bashkëpunimin e shkollave me policinë për sensibilizimin rreth rreziqeve të përdorimit të drogave. Ministri i Brendshëm, Bujar Nishani, tha në fjalën e tij se ky është një projekt inkurajues. Ai shprehu kënaqësinë që në këtë projekt, strukturat shtetërore kishin përkrah partnerë të rëndësishëm si Ambasada e Shteteve të Bashkuara. Ministri i Arsimit, Myqerem Tafaj, deklaroi se lufta kundër drogës fillon me edukimin në shkolla. Ndërmjet Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë dhe Drejtorisë Arsimore të Tiranës sapo është nënshkruar një memorandum i dytë mirëkuptimi, si dhe është hartuar plani i përbashkët i

punës për vitin shkollor 2011-2012, për programin edukativ, i cili shtrihet në 40 shkolla të qytetit të Tiranës.

Trajnim i Njësitë të Lëvizshme të Policisë Kufitare dhe Migracionit

Në nëntor 2011, PAMECA III trajnoi njësitë e lëvizshme të sapokrijuara të Policisë Kufitare dhe Migracionit në Policinë e Shtetit. Kursi i parë u zhvillua në Drejtorinë e Policisë Gjyrokastër, me ushtrime praktike në qytet dhe në pikat e kalimit kufitar të Kakavijes dhe Sarandës. Gjithsej u trajnuan 14 oficerë të PKK-ve në lidhje me policimin bazuar në informacion sekret, observim i fshehtë dhe teknika patrullimi, me qëllim që të rrisnin kapacitetet reaguese të njësitë. Trajnimi që zgjati për dy javë, u fokusua në inskenime, zgjidhje problemesh, intervista investigative dhe teknika komunikimi. Siguria e oficerëve ishte një nga temat kryesore të trajnimit, ku theksi u vu në menaxhimin e riskut dhe vlerësimin dinamik të riskut. Oficerët u njohën edhe me observimin e fshehtë dhe teknikat e patrullimit. Për t'i zotëruar sa më mirë, u zhvilluan ushtrime me patrullim në zona urbane dhe rurale, si edhe operacione natën me ndihmën e mjeteve teknike.

Trajnimi u dha nga dy ekspertë trajnimi të ardhur nga Mbretëria e Bashkuar dhe një këshilltar krimesh i PAMECA III. Feedback-u i marrë nga pjesëmarrësit ishte pozitiv dhe entuziast. Synohet që trajnimi të shtrihet edhe në njësitë e



■ Foto: Ambasadori amerikan, Alexander Arvizu u dorëzon Certifikatat e Mirënjohjes tre efektiveve të Policisë së Shtetit gjatë ceremonisë për zbatimin e përbashkët të Platformës së Edukimit dhe Ndërgjegjësimit për Drogat në shkollat fillore të Tiranës

tjera të Policisë Kufitare dhe Migracionit që punojnë në PKK dhe brenda territorit shqiptar. Kjo do të kontribuojë në përmirësimin e forcës reaguese të PKM-së gjatë përdorimit të metodave bashkëkohore të kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, me qëllim hetimin e krimit të organizuar në kufi dhe rritjen e arrestimeve të trafikantëve të qenieve njerëzore, drogës dhe mallrave.

Eveniment në Shkollën e Magjistraturës për koordinimin e donatorëve

Projekti për Konsolidimin e Drejtësisë në Shqipëri (EURALIUS) ndihmoi Shkollën e Magjistraturës për organizimin e të parit takim koordinues me grupet ndërkombëtare të interesit, me qëllim koordinimin e programeve të asistencës ndërkombëtare për sa i përket Trajnimeve, Publikimeve dhe Bibliotekës për Shkollën. Në këtë takim të zhvilluar në fund të tetorit 2011, morën pjesë përfaqësues të ambasadave, organizatave ndërkombëtare dhe projekteve.

Shkolla e Magjistraturës është institucion kyç për përmirësimin e cilësisë, efikasitetit dhe saktësisë së gjyqësorit shqiptar. Për këtë arsye, mbështetet në punën e tij nga mjaft donatorë ndërkombëtarë. Por kjo ndihmë duhet të koordinohet për të garantuar efikasitetin maksimal, për të shmangur mbivendosjen dhe për të qartësuar prioritetet; në këtë takim të parë,



Foto: Trajnimi i Njësive të Lëvizshme të Policisë Kufitare dhe Migracionit

Drejtorja e Shkollës shpjegoi se aktualisht nuk ka buxhet për programet mësimore të trajnimeve në vazhdim. Shkolla e Magjistraturës ka miratuar një plan publikimesh që u mundëson gjyqtarëve akses në manuale dhe studime që lehtësojnë punën e tyre dhe përmirësojnë diskursin për kuadrin ligjor.

Është zhvilluar edhe një diskutim publik për fushat e ndryshme që duhet të mbështeten si edhe për mundësitë e secilit donator. Takimi do të pasohet nga krijimi i një rrjeti donatorësh dhe kontribuuesish, me synimin që të ngrihet një mekanizëm stabil për përmirësim

min e asistencës ndërkombëtare në këtë fushë.

Ngrihet Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në Tiranë

Më 21 nëntor 2011, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve, Njësia Bashkiake nr. 4 përuroi zyrtarisht Njësinë e re për Mbrojtjen e Fëmijëve, fryt i bashkëpunimit me Bashkinë e Tiranës dhe Fondacionin Terre des Hommes si edhe me mbështetjen e UNICEF-it dhe Agjencia Austriake për Bashkëpunim. Njësia do të ofrojë ndihmë për fëmijët që janë viktima ose të rrezikuar nga dhuna, abuzimi, neglizhimi, shfrytëzimi dhe trafikimi. Njësia do të mbështetë edhe familjet e fëmijëve të rrezikuar. Në këtë eveniment, zv. Kryebashkiakja e Tiranës, Jorida Tabaku, u shprehu mirënjohjen të gjithë donatorëve, OJF-ve, profesionistëve dhe Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr. 4, për angazhimin e tyre në promovimin e mirëqenies së të gjithë qytetarëve që jetojnë brenda juridiksionit të kësaj Njësie Bashkiake.

Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve të komuniteteve, Përfaqësuesi i UNICEF-it në Shqipëri, Detlef Palm, inkurajoi të gjitha grupet e interesit që të mbështesin të parën Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve në Tiranë. "Ne të gjithë duhet të garantojmë që punonjësit e angazhuar në mbrojtjen e fëmijëve të jenë të pajisur



Foto: Ceremonia e përurimit të Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Tiranë

me aftësitë e nevojshme për evidentimin e rasteve të fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje, si edhe të jenë në gjendje të ndërhyjnë siç duhet. Të gjitha strukturat duhet të ofrojnë ndihmën e tyre, përfshi trajnimin në punë dhe akademik. Gjithashtu, ato duhet të japin asistencë teknike dhe të garantojnë aftësinë e Njësisë për të vazhduar aktivitetet e saj edhe në vitet në vazhdim”, u shpreh z. Palm.

Shefja e Agjencisë Austriake për Zhvillim, Astrid Wein, i bëri thirrje pushtetit qendror dhe vendor në Shqipëri të rrisin mbështetjen e tyre për Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, sidomos atë financiare, si edhe për institucionet e tjera të mbrojtjes së fëmijës. “Qeveria shqiptare duhet të bëjë ndryshime strukturore për të ngritur institucione që garantojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ato duhet të ndjekin qasjen e menaxhimit rast pas rasti, pasi kështu garantohet mbrojtja e fëmijëve bazuar në nevojat e tyre individuale” deklaroi znj. Wein.

Përveç 28 Njësisë të ngritura deri tani në mbarë Shqipërinë, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në Tiranë fuqizon kapacitetet drejt një sistemi funksionues për mbrojtjen e fëmijës, “që duhet të përqafohet nga të gjitha Njësitë e tjera Bashkiake të Tiranës”, shtoi Kryetarja e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e Të Drejtave të Fëmijës, Miranda Pasha.

Komunikimi për Ndryshimin e Sjelljes (COMBI) Kundër Dhunës në Shkollë

COMBI nuk është më një term i panjohur për institucionet e arsimit publik të sistemit parauniversitar. Tashmë në zbatim prej 10 muajsh, kjo nismë ka arritur disa objektiva dhe është përballur me sfida të reja. Aktualisht, po zhvillohet një punë voluminoze për të arritur pakësimin e dhunës në shkollat publike, kopshtet dhe institucionet e kujdesit.

Që në qershor 2011, me mbështetjen e UNICEF-it, 11 trajnues organizuan seancat orientuese të trajnimit *Disiplina Mënyra e Re* për 3200 drejtorë, mësues dhe psikologë nga mbarë vendi. Përveç informacionit të përgjithshëm për përmasat e dhunës dhe objektivat e programit, seancat orientuese prezantuan aspektet kryesorë të Disiplinës Mënyra e Re. Ato përfshijnë kartonin PEET, i ng-



■ Foto: Drejtorët, mësuesit dhe psikologët e shkollave gjatë trajnimit “Disiplina Mënyra e Re”

jashëm me kartonin e verdhë të përdorur në ndeshjet e futbollit. Përpara se të reagojë ndaj provokimeve të nxënësve, mësuesi duhet:

Të bëjë pauzë tre sekonda pas incidentit që kërkon masa disiplinore;

Të hulumtojë çfarë po ndodh me fëmijën dhe pse;

Të nxitë fëmijën të sugjerojë një zgjidhje për problemin, ose të ftojë klasën për bashkëpunim;

Të marrë masa jo të dhunshme për ta zgjidhur problemin ashtu siç është rënë dakord me nxënësin ose klasën.

Orientimet sugjerojnë edhe që mësuesit e shkollës të organizojnë ‘Biseda në Kafë’ për problemet dhe zgjidhjet që duhet ndjekur për disiplinimin e nxënësve, pa ushtruar dhunë. Gjatë seancave, u shpërndanë karta diskutimi për nxënësit si edhe plot materiale promovuese, përfshi kartonat PEET për çdo mësues dhe fletushka informuese për Disiplinën Mënyra e Re. Seancat orientuese u zhvilluan në 12 Drejtoritë Arsimore të Qarqeve, në prani të mediave rajonale. Çdo institucion arsimor do të ngrrejë një Grup Avokatësh që do të jetë përgjegjës për zbatimin e programit COMBI.

Koncepti i kartës PEET mbetet sfida më e madhe. Promovimi i metodave alternative nuk ishte i lehtë, po të kihet parasysh historia e sistemit arsimor dhe metodat tradicionale të disiplinës në Shqipëri. Më tepër punë duhet bërë për ta nxitur opinionin publik të pranojë që

rregulli dhe disiplina në klasa mund të garantohet me komunikim të efektshëm mes mësuesve dhe nxënësve.

Programi COMBI tashmë kalon në fazën e monitorimit të Disiplinës Mënyra e Re në institucionet arsimore. Kjo do të ndihmojë në identifikimin e masave shtesë në mbështetje të përgjegjësive të mësuesve dhe anëtarëve të Grupeve të Avokatëve. Në janar 2012 do të zhvillohet fushata e sensibilizimit publik.

Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike – Sfidë për Zhvillim

Më 3 nëntor 2011, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Këshilli i Qarkut Lezhë në bashkëpunim me Programin e UNDP-së për Ndryshimet Klimatike, organizuan *Konferencën Kombëtare me temë “Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike - Sidë për Zhvillim”*. Konferenca ishte pjesë e zbatimit të projektit “Identifikimi dhe zbatimi i masave për përshtatje në deltat e lumenjve Drin e Mat”. Ndryshimet klimatike ndikojnë në çdo aspekt të shoqërisë, mjedisit dhe ekonomisë. Duhet që integrimi i ndryshimeve klimatike në planet e zhvillimit në nivel kombëtar dhe vendor, t’i përgjigjet siç duhet sfidave të reja. Zonat e mbrojtura të lagunave të Kune-Vainit dhe Patokut ndërmjet deltave të lumenjve Drin dhe Mat (DLDM), mbartin vlera biodiversiteti me rëndësi globale dhe

kombëtare. DLDM është identifikuar si zonë mjaft vulnerabël ndaj ndryshimeve aktuale dhe ato të pritshme të klimës, që pritet të shoqërohen me pasoja të mëdha ekologjike dhe social-ekonomike. Përmbytjet intensive, qëndrimi për një kohë të gjatë nën ujë, erozioni intensiv, avancimi i detit dhe kripëzimi do të ndikojnë në jetën e specieve dhe përbëjnë rrezik për humbjen dhe fragmentimin e habitateve. Ndjeshmëria e lartë e kesaj zone, kombinuar me pasojat negative që po vuan biodiversiteti me rëndësi botërore, e bën të domosdoshme që pesha e ndryshimeve klimatike të gjejë urgjentisht vend në të gjitha ndërhyrjet e ardhshme që synojnë të nxitin zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

Në fjalën e tij gjatë konferencës, zv.Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, z. Taulant Bino, nënvizoi: “Projekti ka demonstruar që ekosistemet natyrore të zonës DLDM kanë potencialin të mbrojnë aktivitetet ekonomike, infrastrukturën dhe mjediset e ndërtuara, por nuk do të jenë në gjendje ta bëjnë këtë nën presionin aktual të ndryshimit dhe degradimit. Kjo zonë përbën prioritet kombëtar zhvillimi, dhe përpara nesh është sfida të punojmë së bashku për të përfshirë problematikën e përshtatjes ndaj ndryshimeve të klimës në politikat e zhvillimit jo vetëm të zonës, por edhe më gjerë. Është me interes që rezultatet e këtij projekti të parë të shërbejnë si model që masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimi i integruar të shtrihet përtej zonave bregdetare, deri në ekosistemet malore, npellgun ujëmbledhës të Drinit, apo zona të tjera me rëndësi strategjike për vendin”.

Z. Norimasa Shimomura, Drejtor i Zyrës së UNDP-së në Shqipëri, i cili mori pjesë në konferencë, gjatë fjalës së tij theksoi: “Me ndihmën e UNDP-së është bërë studimi i plotë për deltat e lumenjve Drin e Mat, ku erozioni agresiv po ndryshon vijën bregdetare duke rritur presionin mbi biodiversitetin me rëndësi globale në zonat e mbrojtura të Kune-Vainit dhe Patokut. Komuniteti dhe pushteti vendor kanë marrë pjesë në formulimin e planeve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në fushat kryesore që ndikojnë në jetesën e tyre, si bujqësia, turizmi, ekosistemet dhe menaxhimi i zonës bregdetare”.

Konferenca kombëtare prezantoi për



■ Foto: (nga e majta) Z. Taulant Bino, zv.Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, z. Norimasa Shimomura, Drejtor i Zyrës së UNDP-së për Shqipërinë, znj. Keti Chachibaia, Këshilltare Teknike Rajonale: Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe Zhvillimi i Kapaciteteve

pjesëmarrësit vlerësimin e rreziqeve në zonë, identifikimin e masave përshtatëse, kostot dhe përfitimet e zbatimit të tyre, dhe mënyrat për të integruar masat përshtatëse ndaj ndryshimeve klimatike në planet e zhvillimit në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar dhe sidomos në planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura.

Gjatë konferencës kombëtare u diskutua gjerësisht për masat përshtatëse afatshkurtra dhe afatgjata që mund të zbatohen, të klasifikuara në masa për të ndërtim kapacitetesh përshtatëse dhe masa për zhvillimin e ndërhyrjeve përshtatëse. Disa çështje që mund të trajtohen gjatë ciklit të projektit janë: krijimi i një sistemi të integruar të monitorimit për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve klimatike në ekosisteme, zhvillimi i një Politike Rajonale të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike, ndërmarrjen e aktiviteteve ripërtëritëse pilot (pyllëzi-

min e zonës së Fushë Kuqes, ripërtëritjen e mjedisit në ishullin e Kunes) etj.

Konferenca për Edukimin Mjedisor në Vlorë

“Shqipëria ime e bukur dhe e pastër” është titulli i nismës së komunikimit në kuadrin e projektit CLEEN, projekt i përbashkët ky i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Mjedisit, me mbështetjen e UNICEF-it. Deri tani, 10 rrethe janë pajisur me programin mësimor mbi edukimin mjedisor. Projekti synon të ndryshojë sjelljen e fëmijëve dhe komuniteteve, të mbrojë mjedisin dhe të kontribuojë për pastrimin e Tiranës, Shkodrës, Durrësit, Korçës dhe Elbasanit nga mbetjet plastike. Rezultatet e arritura deri tani, mundësuan shtrirjen më tej të projektit, në Fier dhe Vlorë. Më 23



■ Foto: Konferenca për Edukimin Mjedisor në Vlorë

nëntor 2011, u mbajt në Vlorë një konferencë për të njohur grupet e interesit me sfidat e edukimit mjedisor, aktivitetet e projektit dhe rruga që duhet ndjekur. Fëmijët e shkollave që kishin marrë pjesë në orët e mësimi për edukimin mjedisor, përgatitën një ekspozitë krijuese me materiale të ricikluar. Në evenimentin prezantues ishin të pranishëm znj. Nora Malaj, zv.Ministre e Arsimit dhe Shkencës, z. Taluant Bino, zv.Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, z. Detlef Palm, Përfaqësues i UNICEF-it, Drejtoritë Arsimore të Vlorës së Fierit dhe përfaqësues nga pushteti vendor, bizneset vendase, OJF-të, mësues, prindër, studentë dhe media lokale. Pjesëmarrësit nënvizuan rëndësinë e programeve mësimore mbi edukimin mjedisor. Ata theksuan se ndërgjegjësimi është veçanërisht i rëndësishëm në vitet e para të fëmijës dhe ndihmon në përgatitjen e një brezi fëmijësh që do të bëhen flamurtarë të mbrojtjes së mjedisit.

Koncerti ndëretnik ndez Teatrin e Metropolit

Më 8 nëntor, mbi 250 persona morën pjesë në koncertin ndëretnik muzikor të organizuar në Teatrin Metropol në Tiranë. I titulluar “Harmoni për Paqe dhe Prosperitet”, koncerti mbledhi së bashku pesë muzikantë të rinj romë dhe Dhomen Orkestrale Ballkanike e cila përbëhet nga artistë nga Kosova, Serbia, Maqedonia dhe Shqipëria.

Dirigjuar nga një maestro japonez, koncerti tërhoqi vëmendjen e audiencës të përbërë nga përfaqësues të qeverisë, përfaqësues të trupave diplomatike, për-



■ Foto: Dirigjenti Toshio Yanagisawa, Dhoma Orkestrale Ballkanike dhe muzikantë romë duke interpretuar në Teatrin e Metropolit në Tiranë

faqësues të komunitetit ndërkombëtar, artistë, shoqëria civile dhe shumë të tjerë. Aktiviteti ishte përvojë e mrekullueshme për muzikantët e rinj romë. Kadriu, një violinist 19-vjeçar, u shpreh: “Kjo ishte përvoja më e mrekullueshme e jetës time. Unë mësova shumë duke performuar me muzikantë profesionistë nga Ballkani. Dua të bëhem po aq i mirë sa ata.” Ministri Yuzo Ota, nga Ambasada Japoneze në Itali i pranishëm në koncert, gjatë fjalës së tij tha: “Jam i bindur se suksesi i madh i këtij koncerti për paqen dhe pajtimin etnik është një hap i rëndësishëm. Uroj që kjo lloj harmoni midis grupeve të ndryshme etnike të promovohet më tej dhe që koncepti i Fondit për Sigurinë Njerëzore, krijuar me iniciativë të Japonisë, të materializohet më tej në Ballkan.” Dirigjenti, z. Toshio Yanagisawa, theksoi: “Sot unë kuptova se muzika bazohet në besimin reciprok mes muzikantëve. Performanca e suksesshme e kësaj mbrëmje buroi nga lidhja e fortë me muzikantët romë. Si rezultat kjo u reflektua në tingujt që ne krijuam me

instrumentet tona”. Drejtori i Përgjithshëm i UNDP-së për Shqipërinë, z. Norimasa Shimomura, pjesëmarrës në aktivitet midis të tjerave theksoi: “Aktiviteti i kësaj mbrëmje është një mënyrë për të njohur dhe promovuar vlerat rome dhe trashëgiminë e tyre të pasur kulturore. Ne jemi shumë të emocionuar pasi muzika rome do të performohet në harmoni me Dhomen Orkestrale Ballkanike e cila sjell anëtarësi ndër-etnike nga vende të ndryshme të Ballkanit Perëndimor. Sot, vlerat e kulturave të ndryshme në rajon do të prezantohen artistikisht tek ju, duke përcjellë një mesazh të fuqishëm për paqe dhe prosperitet nëpërmjet harmonisë muzikore. Përfshirja dhe integrimi i romëve është një sfidë zhvillimi dhe respektimi i të drejtave të njeriut. Përfshirja e romëve nënkupton gjithashtu respektim i kulturës, gjuhës, identitetit dhe historisë së tyre. Shoqëria mund të arrijë prosperitet vetëm kur çdo pjesë e shoqërisë merr pjesë aktivisht dhe kontribuon në vizionin e saj”.

Aktiviteti u organizua në kuadër të

Raporti Periodik Ekonomik për Evropën Juglindore

Më 15 nëntor 2011, Banka Botërore publikoi “Raportin e Rregullt Ekonomik për Evropën Juglindore” (SEE RER). Ky është i pari i një serie raportesh që do të publikohen çdo 6-mujor. Raporti krahason treguesit e rritjes ekonomike, tregtisë, performancën fiskale dhe të sektorit bankar në gjashtë vende të Evropës Juglindore, dhe analizon ndikimin e ngadalësimit global dhe të turbulencave në ekonomitë e Eurozonës. Raporti përmban edhe një veçori, sepse fokusohet te arsimit, kërkimi shkencor dhe zhvillimi, si edhe novacioni. Për ta lexuar raportin e plotë, klikoni [këtu](#).

■ Foto: Ballina e “Raportit të Rregullt Ekonomik për Evropën Juglindore”

Programit të Përbashkët Një OKB “Fuqizimi i Komuniteteve Lokale në Nevojë në Shqipëri”. Programi synon të ndihmojë në integrimin social të komuniteteve rome dhe egjiptiane në nevojë duke vlerësuar diversitetin e tyre. Ai mbështet pjesëmarrjen e komuniteteve në nevojë në vendimmarrje lokale nëpërmjet identifikimit të prioriteve dhe hartimit të Planeve të Zhvillimit të Komunitetit. Mbështetje i

ofrohet fuqizimit të këtyre komuniteteve për të pasur akses në shërbimet publike nëpërmjet regjistrimit civil; policimit në komunitet; për krijimin dhe forcimin e rrethit të ndërmjetësve të komunitetit në fushën e shëndetësisë, si dhe lehtësimin e trajnimeve profesionale dhe punësimit.

Programi gjithashtu promovon fuqizimin e institucioneve dhe politikave për përfshirjen sociale të komuniteteve në

nevojë, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve dhe asistencës për institucionet vendore dhe ato qendrore, rritjes së kapaciteteve dhe formimit të partneritetit me OJF-të rome dhe egjiptiane.

Projekti zbatohet në katër qarqe të Shqipërisë: Tiranë, Elbasan, Fier dhe Durrës dhe financohet nga Fondi i Besimit i OKB-së për Sigurinë Njerëzore me mbështetjen e qeverisë së Japonisë.

Misionet në vend

BANKA BOTËRORE

Portofoli i Sektorit Energjetik në Shqipëri, (30 nëntor - 9 dhjetor 2011): Objektivat kryesorë të misionit ishin: a) të analizohej ecuria e zbatimit të termocentralit të Vlorës, modalitetet për përgatitjen e Raportit të Përfundimit të Zbatimit dhe çështje të tjera; b) të analizoheshin zhvillimet e fundit të procesit të privatizimit në kuadrin e PRG-së (Garantimit të Pjesshëm të Riskut). Ndërsa në terren, misioni vëzhgoi ecurinë e zbatimit teknik në kuadrin e projektit APL2. Si pjesë e marrëveshjes mes UNDP-së dhe Bankës Botërore për Mbështetjen e Qeverisjes Ekonomike - Komponenti ‘Sektorit Energjetik’, misioni u takua me të gjitha grupet e interesit për të marrë këndvështrimin e tyre rreth projekt-vlerësimit të Modelit të Tregut të Elektricitetit dhe efekteve të ndryshimeve të propozuara për Ligjin e Energjisë.

Projekti për Ofrimin e Shërbimeve Sociale, Misioni Mbështetës për Zbatimin (30 nëntor - 5 dhjetor 2011): Objektivat kyç të misionit ishin: (i) të shikohej ecuria e zbatimit të projektit, sidomos aktivitetet në vazhdim dhe ato të mbetura; (ii) të kryheshin inspektime në terren për ndërtimin e Arkivës së Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) si edhe zyrat rajonale ISSH, rehabilitimi fizik i të cilave mbështetet nga fondet e projektit; (iii) të përditësohej kuadri i rezultateve të projektit; (iv) të analizoheshin shifrat e lëvrimit të fondeve (aktuale dhe të planifikuara); (v) të kryhej kontrolli i procedurave të prokurimit dhe të disku-

tohej për çështje që lidhen me rishikimin e planit të prokurimeve (nëse ka), si edhe çështje të prokurimit për punimet në vazhdim; dhe (vi) të kryenin vlerësimin e dytë të masave mbrojtëse.

Projekti për Modernizimin e Sistemit Shëndetësor (P082814), Misioni Mbështetës i Zbatimit (21-25 nëntor 2011): Objektivat kyç të misionit ishin: (i) të shikohej ecuria e zbatimit të projektit, sidomos aktivitetet e mbetura; (ii) të kryheshin inspektime në terren për pajisjet kryesore spitalore të blera së fundmi me fondet e projektit; (iii) të diskutoheshin me ISSH-në për pajisjet elektronike (mbështetur nga projekti) dhe për koordinimin me Zyrën Austriake për Bashkëpunim në lidhje me softuerin e sistemit; (iv) të diskutoheshin dhe të arrihej marrëveshje me Qeverinë për aktivitetet e mbetura të projektit, me synim përfundimin me sukses të projektit në mars 2012;

dhe (v) të përditësohej kuadri i rezultateve të projektit.

Fondi Shumëpalësh i Besimit (TF 090483), Raporti i Përfundimit të Zbatimit (15-18 nëntor 2011): Objektivi kryesor i vizitës ishte të fillohej puna për përgatitjen e Raportit të Përfundimit të Zbatimit për Sistemin e Planifikimit të Integruar të Fondit Shumëpalësh të Besimit në këto mënyra: (i) duke analizuar progresin e arritur nga SPI, bazuar në takimet me përfituesit e projektit, përfshi Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave dhe disa ministri linje; (ii) duke analizuar sa janë arritur rezultatet dhe treguesit e performancës si rezultat i zbatimit të projektit; dhe (iii) duke vlerësuar projektimin dhe zbatimin e SPI-së që të nxirren mësimet për operacionet pa-suese. Misioni diskutoi me homologët qeveritarë dhe donatorët për detajet e operacioneve të mëtejshme të SPI 2.

dialoguqeveridonatorë

Nga data 1 korrik 2011, USAID mori Kryesimin e Sekretariatit Teknik të Donatorëve nga Banka Botërore

Të gjitha komentet lidhur me Dialogun Qeveri-Donatorë janë më se të mirpëritura!

Doni të kontribuoni?

Nëse dëshironi të kontribuoni, dërgoni tekstin tuaj në zyrën e Sekretarit Teknik të Donatorëve (nevila.como@aidharmonisation.org.al) ose në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj (koordinimi@km.gov.al) deri më datë 5 të çdo muaji. Teksti duhet të jetë mundësisht rreth 100 fjalë.

Shpërndarja:

Çdo botim do t'ju dërgohet më datë 15 të çdo muaji.

Cilët janë donatorët në Shqipëri?

Për të zbuluar cilët janë donatorët që operojnë në Shqipëri, klikoni [këtu](#).

Për t'u çregjistruar:

Lutemi dërgoni e-mail tek Nevila Çomo (nevila.como@aidharmonisation.org.al)

OSCE Buletini Dialogu Qeveri Donatorë mbështetet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

